

**V E N D I M**  
**Nr.525, datë 1.8.2003**

**PËR RIORGANIZIMIN E NDËRMARRJEVE TË TRAJTIMIT TË STUDENTËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 121 e 124 të Kodit të Procedurave Administrative, të pikës 1 të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 9.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", të nenit 16 të ligjit nr.8939, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003" dhe të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Riorganizimin, sipas juridiksionit territorial ku veprojnë, të qendrave studentore, si ndërmarrje me subvencione shtetërore, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, në funksion të trajtimit të studentëve, jashtë procesit mësimor, si më poshtë vijojnë:

- a) Ndërmarrja e trajtimit të studentëve nr.1, Tiranë (NTS 1);
- b) Ndërmarrja e trajtimit të studentëve nr.2, (NTS 2);
- c) Ndërmarrja e trajtimit të studentëve nr.3, Tiranë (NTS 3);
- ç) Ndërmarrja e trajtimit të studentëve, Shkodër (NTSSH);
- d) Ndërmarrja e trajtimit të studentëve, Elbasan (NTSE);
- dh) Ndërmarrja e trajtimit të studentëve, Korçë (NTSK);
- e) Ndërmarrja e trajtimit të studentëve, Vlorë (NTSV);
- ë) Ndërmarrja e trajtimit të studentëve, Gjirokastër (NTSGJ).

2. Drejtoria e Përgjithshme e Qendrave Studentore (DPQS), ndërmarrja e gjelbërimit të mjediseve studentore (NGJMS) dhe ndërmarrja e elektrik-ujësjellësit të mjediseve studentore (NEUMS), të shkrihen.

3. Mjediset e administruara nga strukturat e përmendura në pikën 2 të këtij vendimi, të kalojnë në administrim të ndërmarrjeve të trajtimit të studentëve, sipas juridiksionit territorial të tyre, të cilat të realizojnë edhe funksionet e këtyre strukturave.

4. Drejtuesit e ndërmarrjeve të trajtimit të studentëve emërohen nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës.

5. Për punonjësit, që pas riorganizimit mbeten pa punë, të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

6. Buxheti i mbetur i strukturave që shkrihen, të cilat kanë qenë në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, t'u kalojë përkatësisht, ndërmarrjeve që do t'i kenë në administrim. Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, në buxhetin e miratuar për vitin 2003, t'i shtohen fondet, për periudhën e mbetur të këtij viti, në zërat "Subvencion" dhe "Shpenzime kapitale", të cilat do t'i pakësohen buxhetit të vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, për ndërmarrjet e trajtimit të studentëve, sipas pikës 1, në përputhje me aktrakordin ndërmjet palëve.

7. Vendimi nr.214, datë 15.7.1991 i Këshillit të Ministrave "Për shkëputjen e veprimtarisë jetësore të studentëve nga drejtimi i shkollave të larta", i ndryshuar, vendimi nr.395, datë 12.8.1999 i Këshillit të Ministrave "Për riorganizimin e qendrave studentore" dhe vendimi nr.145, datë 31.3.2000 i Këshillit të Ministrave "Për riorganizimin e qendrave studentore", shfuqizohen.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**